




Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 17.12.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-3965/14, për znj. Vjollca Sylejmani, Anëtare e Kuvendit Komunal në Viti, për shkak se zyrtarja e lartë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtaren e lartë, znj. Vjollca Sylejmani, Anëtare e Kuvendit Komunal në Viti, dhe njëkohësisht, person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Në rastin e lartëpërmendur, zyrtarja e lartë znj. Sylejmani është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, Pas pranimit të kësaj shkrese, kemi organizuar një takim me zyrtaren e lartë. Me këtë rast ajo është njoftuar me fakte për situatën e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, në të cilin ndodhet.

Zyrtarja e lartë znj. Sylejmani ka pranuar rekomandimin e Agjencisë, për të bërë ndryshimet e nevojshme në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, për të shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtarja e lartë znj. Sylejmani ka sjellë në Agjenci një shkresë zyrtare (DPKI-03-4728), në të cilën vërtetohet se e njëjta është larguar nga funksioni si person i autorizuar në biznesin privat D.P.T. "Vjollca-S", për të ushtruar funksionin publik si Anëtare e Kuvendit Komunal të Vitisë.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

